VENDIM
Nr.495, datë 1.8.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE SHTESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" të ndryshuar dhe të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga mujore e personelit diplomatik të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja, të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore është sipas kolonës 1 të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Përveç pagës bazë mujore, të përcaktuar sipas lidhjes nr.1 kolona 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, personeli diplomatik i përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja, përfiton edhe 75 për qind mbi pagën bazë mujore, titullari i përfaqësisë dhe 40 për qind, personeli tjetër diplomatik.

4. I ngarkuari me punë në përfaqësitë, në vendet, me të cilat kemi marrëdhënie në këtë nivel, paguhet me gradën e Ministrit Këshilltar.

5. I ngarkuari me punë a.i., paguhet me një gradë më të lartë, se ajo që mban, për kohën, që ushtron këtë funksion.

6. Përveç pagës mujore, të përcaktuar sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, personeli diplomatik i përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtete e huaja, përfiton edhe kompensim për koston e jetesës. Kategorizimi i përfaqësive diplomatike, për efekt të kostos së jetesës, të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Masa e kompensimit për koston e jetesës është, si më poshtë vijon:

- 300 euro/USD, për vendet e grupit të parë;
- 260 euro/USD, për vendet e grupit të dytë;
- 230 euro/USD, për vendet e grupit të tretë;
- 200 euro/USD, për vendet e grupit të katërt;
- 150 euro/USD, për vendet e grupit të pestë.

8. Pagat e personelit administrativo-teknik në përfaqësitë diplomatike edhe kur në këto pozione punësohen shtetas të vendit ku ndodhet përfaqësia diplomatike, të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Pagesa e punonjësve të personelit administrativo-teknik, të punësuar me kohë të pjesshme të jetë sipas lidhjes 3/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Aplikimi i nivelit maksimal apo minimal, përcaktohet në varësi të ngarkesës së punës, me urdhër të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

10. Përcaktimi i pozicioneve administrativo-teknike, në përfaqësitë diplomatike, me kohë të plotë apo të pjesshme, deri në miratimin e plotë nga Kryeministri të strukturave të përfaqësive diplomatike, bëhet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

11. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të saj do të paguhen edhe detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

12. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit në të njëjtën formë si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

13. Kategorizimi i përfaqësive diplomatike, të përcaktuar sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, mund të rishikohen jo më shpesh se një herë në vit.

14. Pagesa për përfaqësitë diplomatike në vendet e Kontinentit Europian bëhet në euro, ndërsa për vendet e tjera në USD.

15. Pikat 1, 12, 13 e 14 të vendimit nr.673, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave "Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja", shfuqizohen.

16. Deri në fund të vitit 2007, numri i punonjësve të përfaqësive diplomatike është gjithsej 376 veta, nga të cilët 178 veta personel diplomatik dhe 198 veta punonjës administrativo-teknik.

17. Funksionet, që eliminohen paguhen, deri më 1 shtator 2007, me pagën ekzistuese.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i viti 2007, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

PAGA MUJORE E PERSONELIT DIPLOMATIK TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	1	2
	Paga bazë mujore (në euro dhe dollarë USA)	Shtesë për përfaqësimin (në %)
Ambasador	1200 euro 1460 dollarë USD	75%
Konsull i Përgjithshëm	900 euro	75%
Ministër Fuqiplotë	1100 dollarë USD	40%
Ministër Këshilltar		40%
Këshilltar	750 euro 950 dollarë USD	40%
Sekretar i Parë Konsull	600 750 dollarë USD	40%
Sekretar i Dytë	450	40%
Zëvendëskonsull	590 dollarë USD	
Sekretar i Tretë	400	40%
Agjent Konsullor	500 dollarë USD	
Atashe	350 450 dollarë USD	40%

LIDHJA NR.2

KATEGORIZIMI I PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE, NË BAZË TË KOSTOS SË JETESËS

Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
1.Misioni NY	1.Vienë	1.Bruksel	1.Zagreb	1.Shkup
2.Konsull NY	2.Misioni OSBE	2.NATO	2.Kajro	2.Prishtinë
3.Londër	3.Washington	3.Athinë	3.Janinë	3.Sofie
4.Gjenevë	4.Paris	4.Ankara	4.Bari	4.Podgoricë
5.Kopenhagë	5.Romë	5.Hagë	5.K.Lumpur	5.Buenos Aires
6.Berne	6.Strasbourg	6.Stokholm	6.Riad	6.Bukuresht
7.Moskë	7.Berlin	7.Warshavë		
8.Pekin	8.Madrid	8.Budapest		
9.Tokio	9.Ottava	9.Pragë		
10.Milano	10.UNESKO	10.Beograd		
11.Stamboll	11.Vatikan	11.Selanik		
		12.Tel-Aviv		

LIDHJA NR.3

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO TEKNIK (ME KOHË TË PLOTË), TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar teknik Financier Specialist	750 euro 870 dollarë USD	710 euro 820 dollarë USD	680 euro 790 dollarë USD	650 euro 760 dollarë USD	600 euro 700 dollarë USD
Shofer	700 euro 800 dollarë USD	660 euro 760 dollarë USD	630 euro 730 dollarë USD	600 euro 700 dollarë USD	550 euro 650 dollarë USD
Kafaz	590 euro 670 dollarë USD	550 euro 620 dollarë USD	520 euro 590 dollarë USD	490 euro 550 dollarë USD	440 euro 500 dollarë USD

LIDHJA NR.3/1

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO TEKNIK (ME KOHË TË PJESSHME) TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore (me kohë të pjesshme)				
	Minimum	Maksimum			
Sekretar teknik Financier Specialist	2790 euro 300 USD	400 euro 450 Usd			
Pastrues	200 euro 220 Usd	270 euro 300 Usd			